



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

K.Dh.Sh.II.nr.1316/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Auto Kaçandolli Sh.P.K, me seli në Prishtinë, kundër debitorit “Alba Group” ShPK me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Jupolli&Associates në Prishtinë, për shkak të borxhit sipas dokumentit të besueshëm - Faturave, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhoma e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1774/22, të datës 29.06.2023, me datën 24.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Auto Kaçandolli Sh.P.K, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhoma e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1774/22, të datës 29.06.2023 VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.1774/22, të datës 29.06.2023, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit “Alba Group” ShPK, me numër unik identifikues 810829864, ashtu që ka anuluar pjesërisht Urdhrin Përmbartimor P.nr.07/22 i lejuar me datë 12.01.2022, nga Përmbartuesi Privat Atip Mustafa për pjesën e detyrimit në shumën prej 1,287.11€, ndërsa në pikën II të dispozitivit e ka refuzuar pjesërisht si të pabazuar prapësimin e debitorit Alba Group” ShPK me numër unik identifikues 810829864, për pjesën e detyrimit në lartësi prej 2,218.91€, dhe në këtë pjesë Urdhri përmbartimor P.nr.07/22 i lejuar me datë 12.01.2022, nga Përmbartuesi privat Atip Mustafa, Mbetet në fuqi.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar kreditori për shkak të shkeljeve thelbësore e të dispozitave të procedurës përmbarimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa e parashtruar, ashtu që të priset aktvendimi i atakuar dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje ose të ndryshohet aktvendimi KPPP.nr.1774/22 dt.29.06.2023 i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë ashtu që të refuzohet në tërësi prapësimi i debitorit Alba Group” ShPK me NUI: 710829864 me adresë në Prishtinë si dhe të vërtetohet urdhri P.nr.07/22 dt.12.01.2023 i Përmbaruesit privat Atip Mustafa për lejimin e përmbarimit.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Auto Kaçandolli Sh.P.K, me seli në Prishtinë, me datën 11.01.2022, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit “Alba Group” ShPK me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm – faturave FD04427/2021 dt.16.06.2021, fatura nr.FD08237/2021 dt.26.10.2021, fatura nr.FD08991/2021 dt.01.12.2021, fatura nr.FD08726/21 dt.18.11.2021, fatura nr.FD07989/2021 dt.12.10.2021, Fatura nr.FD07034/2021 dt.03.09.2021 për shumën e borxhit në vlerë prej 3,506.02 €.

Kundër urdhrimit mbi lejimin e përmbarimit debitori ka paraqitur prapësim me të cilën ka kërkuar që të anulohet urdhri për përmbarim për shkak se kreditori nuk ka specifikuar qartë se cilat fatura janë të papaguara dhe se është dashur që ta saktësoj borxhin e saktë për përmbarim bazuar në faturat e prezantuara dhe jo në mënyrë paushallë të kërkoj pagesën e faturave. Faturat e paraqitura në propozim për përmbarim nuk përmbajnë vulën e kreditorit çka është në kundërshtim me LPP-së. Kreditori ka dështuar të argumentoj ekzistimin e detyrimit të debitorit ndaj tij, i propozon gjykatës që ta aprovoj në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të shfuqizohet.

Kreditori në përgjigjen në prapësim thekson s prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe se nuk ekzistojnë asnjëra nga shkaqet për anulimin e urdhrin përmbartimor sipas nenit 71 të LPP-se, janë të paqëndrueshme pretendimet se borxhi është paraqitur në mënyrë paushallë, ngase iniciimi i procedurës përmbartimore është bërë mbi bazën e faturave konform nenit 29 të LPP-së, dhe se borxhi i debitorit është i detajuar dhe përshkruar si në kartelë financiare ku janë specifikuar shumatat për secilën faturë që është obligim i mbetur i debitorit.

Duke vendosur mbi prapësimin e debitorit, gjykata e shkallës së parë ka nxjerr aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1774/22 të datës 29.06.2023, me të cilin ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit “Alba Group” ShPK, si në dispozitiv të aktvendimit. Në arsyetim të vendim gjykata e shkallës së parë thekson se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar, duke referuar vendimin ne nenin 29 par.1dhe 3 të LPP-së. Gjykata gjeti se urdhri përmbartimor duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori ne vlere prej 1,287.11€ dhe atë sipas faturave FD08237/2021 dt.26.10.2021 dhe faturës FD28726/2021 dt.18.11.2021 për shkak se këto fatura nuk i plotësojnë kriteret e parapara me nenin 29 dhe 37 të LPP-së. ngase në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që këto fatura janë të pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht kreditori me asnjë provë nuk ka dëshmuar se të njëjtat janë dorëzuar tek debitori. Gjykata vendosi si ne pikën II të dispozitivit duke lënë në fuqi pjesën tjetër te Urdhrit përmbartimor P.nr.07/2022 dt.12.01.2022 për shumën në vlerë prej 2,218.91€, sipas faturave FD04427/2021 dt.16.06.2021, faturës FD089914/2021 dt.01.12.2021, faturës FD07989/2021 dt.12.10.2021 dhe faturës FD07034/2021 dt.03.09.2021, ngase këto fatura i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm në kuptim të nenit 29 të LPP-së, ne secilën prej tyre janë treguar palët, janë përshkruar mallrat, që kanë qenë objekt i faturës, shuma e detyrimit për përmbushje nga debitori, koha e përmbushjes se detyrimit dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka marr aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozitat e procedurës përmbartimore. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se urdhri përmbartimor duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori në vlerë prej 1,287.11€, dhe atë sipas faturave FD08237/2021 e datës 26.10.2021 dhe faturës FD28726/2021 e datës 18.11.2021, për shkak se këto fatura nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së, ngase në rastin konkret mund të vërtetohet se këto fatura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht kreditori me asnjë provë

nuk ka dëshmuar se të njëjtat janë dorëzuar tek debitori, pasi të njëjta nuk janë të nënshkruara dhe as të vulosura nga ana e debitorit, dhe si të tilla nuk janë të përshtatshme për përbarim.

Së këndejmi, Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar edhe pjesën tjetër të borxhit në shumë prej 2,218.91€, sipas faturave nr.FD04427/2021 e datës 16.06.2021, faturës nr.FD089914/2021 e datës 01.12.2021, Faturës nr.FD07989/2021 e datës 12.10.2021, si dhe faturës nr.FD07034/2021, e datës 03.09.2021, ngase këto fatura i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm në kuptim të nenit 29 të LPP-së.

Rrjedhimisht, kjo gjykatë vlerëson se nisur nga fakti se procedura përbarimore paraqet procedurë formale që i nënshtrohet shqyrtimit formal të dokumenteve përbarimore dhe/apo atyre të besueshme, rrjedh se si kusht esencial mbi bazën e së cilës mund të lejohet përbarimi janë tiparet e përbarueshmërisë së dokumentit të besueshëm e të cilit në rastin konkret i mungojnë kushtet nga Neni 29 par.3 dhe 37 i LPP-së. Së këndejmi, Gjykata thekson se pa plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm nuk mund ta ketë fuqinë e titullit përbarues sepse rezulton se debitori nuk e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përbarimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përbarimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore nuk janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përbarimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

K.Dh.Sh.II.nr.1316/23 me datë 24.05.2024

Gjyqtari
Krenar Berisha